

## **Nis në Gjirokastrë Trajnimi Ndërkombëtar për Shpëtimin e Trashëgimisë Shpirtërore në Rrezik**

*Tiranë, 21 Nëntor* - 28 profesionistë të rinj të muzeve dhe trashëgimisë nga Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Bjellorusia, Egjipti, Gjeorgjia, Irani, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia, po marrin pjesë në një trajnim tri-javor mbi ruajtjen dhe shpëtimin e koleksioneve muzeale, siteve të trashëgimisë dhe trashëgimisë shpirtërore në situata katastrofe.

“Trajnimi Ndërkombëtar Mbi Menaxhimin e Rrezikut për Trashëgiminë Kulturore në Rast Katastrofe” organizohet nga tri zyrat e organizatës “Trashëgimia Kulturore pa Kufij” në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Trajnimi ka filluar në Sarajevë, në Muzeun Kombëtar të Bosnje-Hercegovinës, vijoi në Prishtinë, dhe java e tretë dhe përmblyëse po mbahet në Gjirokastrë në datat 21 nëntor – 27 nëntor.

Programi gërsheton ligjërata nga lektorë rajonalë dhe ndërkombëtare me ushtrime praktike që reflektojnë situata katastrofash për të testuar dijet e pjesëmarrësve. Qëllimi i trajnimit është që profesionistët e trashëgimisë të mësojnë aftësi praktike për mbrojtjen dhe shpëtimin e koleksioneve muzeale, siteve të trashëgimisë dhe të trashëgimisë shpirtërore para, gjatë dhe pas një katastrofe.

Në javën e tretë të trajnimit, pjesëmarrësit po studiojnë mënyra të ndryshme dhe strategji për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore. Disa nga temat më të rëndësishme që do të diskutohen janë: vlerësimi i rrezikut për trashëgiminë kulturore shpirtërore, rëndësia e dokumentimit të kësaj trashëgimie etj.

Një rëndësi e veçantë do t’i kushtohet temës përmes një paneli, që mbahet ditën e premte, ku do të bëjnë pjesë specialistë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore, të emergjencave civile dhe donatorë.

Trajnimi organizohet nëpërmjet projektit rajonal “Ndihma e Parë për Kulturën në Ballkan” (B+CARE), një platformë e themeluar në mars të vitit 2016 për të frymëzuar, trajnuar dhe koordinuar vullnetarë për përgatitjen dhe ndihmën në emergjencat kulturore.

Ky trajnim është financuar nga Prince Clause Fund dhe Qeveria e Suedisë.

Për informacione të mëtejshme jeni të lutur të kontaktoni me *Xhafer Rakipllarin*, përgjegjës i komunikimit në CHWB Albania, në numrin e telefonit: 068 45 02 333 ose email: [xhafer.rakipllari@chwb.org](mailto:xhafer.rakipllari@chwb.org)